



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 114

Tiranë – E enjte, 2 korrik 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9141, datë 17.6.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 6021
Vendim i GJEDNJ datë 24.3.2015	Çështja “Elvin Lako kundër Shqipërisë” - ankimi nr. 45718/12 dhe shtatë ankime të tjera..... 6021
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 20, datë 3.6.2015	Për mosshqyrtim të propozimeve për ndryshim tarife..... 6023
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 21, datë 3.6.2015	Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë “U Korçë Fshat” sh.a..... 6024
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 22, datë 3.6.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 6, datë 26.3.2012 “Licencim për herë të parë ujësjellës Himarë sh.a.”..... 6024

**DEKRET****Nr. 9141, datë 17.6.2015****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare” të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Nisreen Ahmad Al Bitar
2. Beqir Regjep (Rexhep) Hajzeraj
3. Turan Mehmet Şan
4. Mehmet Emir Turan Şan
5. Şenol Arif Damar
6. Berat Mustafa Demir
7. Ismet Şakir Aktürk
8. Emre Şakir Ismet Aktürk
9. Iryna (Irina) Vasyi (Vasil) Zayachkivska (Zajaçkivska)
10. Adelina Hashim Berisha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

**GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT**

SEKSIONI I KATËRT**VENDIM**

Ankimi nr. 45718/12
Elvin Lako kundër Shqipërisë
dhe 7 ankime të tjera
(shiko listën bashkëngjitur)

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), e mbledhur si një Komitet, më 24 mars 2015 i përbërë nga:

Paul Mahoney, President,
Ledi Bianku,

Krzysztof Wojtyczek, gjyqtarë,
dhe Fatoş Aracı, Zëvendës Sekretar i
Seksionit

Pasi ka diskutuar ankesat e mësipërme,
Pasi ka diskutuar deklaratimet formale në të
cilat pranohet marrëveshja miqësore e çështjeve.

Pas diskutimeve, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

1. Një listë me ankuesit gjendet tek shtojca.
2. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjenti i saj, anj. A. Hicka, nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Të gjithë ankuesit shprehën pakënaqësinë se kishte pasur një shkelje të nenit 6§1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimeve të gjykatës së formës së prerë të dhëna në favor të tyre. Për sa i përket ankesave nr. 45718/12, 9403/13, 11724/13, 11726/13, 38964/13 dhe 48723/14, gjykatat vendase urdhëruan rikthimin e ankuesve në punën e tyre, duke shtuar edhe pagesën e pagave të prapambetura deri në rikthimin e tyre në punë. Në lidhje me ankesën nr. 6037/14 dhe 17174/14 gjykatat vendase urdhëruan vetëm pagesën e dëmeve ndaj ankuesve. Dy ankues shprehën pakënaqësinë gjithashtu në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës (ankimet nr. 11724/13 dhe 11726/13) dhe pesë prej tyre mbështetur në nenin 13 të Konventës (ankesat nr. 45718/12, 11724/13, 11726/13, 6037/14 dhe 17174/14).

4. Në lidhje me ankesën nr. 45718/12, më 13 nëntor 2014 dhe 12 janar 2015, Gjykata mori disa deklaratime për marrëveshje miqësore të firmosura nga palët, sipas së cilave, ankuesi binte dakord të hiqte dorë nga kërkesa të tjera kundër Shqipërisë, në lidhje me faktet që i hapin rrugë kësaj ankese kundër një sipërmarrje nga Qeveria, për të zbatuar të plotë vendimin vendas të formës së prerë, të dhënë në favor të tij, brenda tre muajve, si edhe t'i paguante atij 3,300 euro (tre mijë e treqind euro) për të mbuluar dëmet jo monetare si edhe kostot dhe shpenzimet.

5. Në lidhje me ankesën nr. 9403/13, më 13 nëntor 2014 dhe 12 janar 2015, Gjykata mori disa deklarata për marrëveshje miqësore të firmosura nga palët, sipas së cilave, ankuesi binte dakord të hiqte dorë nga kërkesa të tjera kundër Shqipërisë, në lidhje me faktet që i hapin rrugë kësaj ankese kundër një sipërmarrje nga Qeveria, për të zbatuar



të plotë vendimin vendas të formës së prerë, të dhënë në favor të tij, brenda tre muajve, si edhe t'i paguante atij 1,700 euro (një mijë e shtatëqind euro) për të mbuluar dëmet jo monetare si edhe kostot dhe shpenzimet.

6. Në lidhje me ankesën nr. 11724/13, më 18 nëntor 2014 dhe 12 janar 2015, Gjykata mori disa deklarata për marrëveshje miqësore të firmosura nga palët, sipas së cilave, ankuesi binte dakord të hiqte dorë nga kërkesa të tjera kundër Shqipërisë në lidhje me faktet që i hapin rrugë kësaj ankese kundër një sipërmarrje nga Qeveria për të zbatuar të plotë vendimin vendas të formës së prerë, të dhënë në favor të tij, brenda tre muajve, si edhe t'i paguante atij 2,000 euro (dy mijë euro) për të mbuluar dëmet jo monetare si edhe kostot dhe shpenzimet.

7. Në lidhje me ankesën nr. 11726/13, më 18 nëntor 2014 dhe 12 janar 2015, Gjykata mori disa deklarata për marrëveshje miqësore të firmosura nga palët, sipas së cilave, ankuesi binte dakord të hiqte dorë nga kërkesa të tjera kundër Shqipërisë në lidhje me faktet që i hapin rrugë kësaj ankese kundër një sipërmarrje nga Qeveria për të zbatuar të plotë vendimin vendas të formës së prerë, të dhënë në favor të tij, brenda tre muajve, si edhe t'i paguante atij 1 400 euro (një mijë e katërqind euro) për të mbuluar dëmet jo monetare si edhe kostot dhe shpenzimet.

8. Në lidhje me ankesën nr. 38964/13, më 10 nëntor 2014 dhe 12 janar 2015, Gjykata mori disa deklarata për marrëveshje miqësore të firmosura nga palët, sipas së cilave, ankuesi binte dakord të hiqte dorë nga kërkesa të tjera kundër Shqipërisë në lidhje me faktet që i hapin rrugë kësaj ankese kundër një sipërmarrje nga Qeveria për të zbatuar të plotë vendimin vendas të formës së prerë, të dhënë në favor të tij, brenda tre muajve, si edhe t'i paguante atij 4,700 euro (katër mijë e shtatëqind euro) për të mbuluar dëmet jo monetare si edhe kostot dhe shpenzimet.

9. Në lidhje me ankesën nr. 6037/14, më 13 tetor 2014 dhe 12 janar 2015, Gjykata mori disa deklarata për marrëveshje miqësore të firmosura nga palët, sipas së cilave, ankuesi binte dakord të hiqte dorë nga kërkesa të tjera kundër Shqipërisë në lidhje me faktet që i hapin rrugë kësaj ankese kundër një sipërmarrje nga Qeveria për të zbatuar të plotë vendimin vendas të formës së prerë, të dhënë në favor të tij, brenda tre muajve, si edhe t'i

paguante atij 6,300 euro (gjashtë mijë e treqind euro) për të mbuluar dëmet jo monetare, si edhe kostot dhe shpenzimet.

10. Në lidhje me ankesën nr. 17174/14, më 13 tetor 2014 dhe 12 janar 2015, Gjykata mori disa deklarata për marrëveshje miqësore të firmosura nga palët, sipas së cilave, ankuesi binte dakord të hiqte dorë nga kërkesa të tjera kundër Shqipërisë në lidhje me faktet që i hapin rrugë kësaj ankese kundër një sipërmarrje nga Qeveria për të zbatuar të plotë vendimin vendas të formës së prerë, të dhënë në favor të tij, brenda tre muajve, si edhe t'i paguante atij 10, 500 euro (dhjetë mijë e pesëqind) euro për të mbuluar dëmet jo monetare, si edhe kostot dhe shpenzimet.

11. Në lidhje me ankesën nr. 48723/14, më 13 tetor 2014 dhe 12 janar 2015, Gjykata mori disa deklarata për marrëveshje miqësore të firmosura nga palët, sipas së cilave, ankuesi binte dakord të hiqte dorë nga kërkesa të tjera kundër Shqipërisë në lidhje me faktet që i hapin rrugë kësaj ankese kundër një sipërmarrje nga Qeveria për të zbatuar të plotë vendimin vendas të formës së prerë, të dhënë në favor të tij, brenda tre muajve, si edhe t'i paguante atij 2,000 euro (dy mijë euro) për të mbuluar dëmet jo monetare si edhe kostot dhe shpenzimet.

12. Sipas deklaratave të marrëveshjeve miqësore, shpërblimet e mësipërme do të konvertohen në vlerën monetare vendase, sipas normës së aplikueshme në datën e pagesës dhe përjashtohen nga çdo taksë ekzistuese. Ato janë të pagueshme brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të marrë nga Gjykata. Në rast se këto pagesa nuk bëhen brenda periudhës tre mujore, Qeveria ndërmerr të paguajë një interes të thjeshtë për to, nga përfundimi i asaj periudhe deri në shpagim të plotë, në një normë të barabartë me normën e huas marxhinale të Bankës Qendrore Botërore gjatë periudhës së vonesës plus 3% pikë. Zbatimi i plotë i vendimeve përfundimtare, siç është procedura, brenda tre muajve, si edhe pagesat për të gjitha ankesat, do të përbëjnë zgjidhjen përfundimtare të çështjeve.

LIGJI

13. Gjykata shqyrton marrëveshjet miqësore të arritura midis palëve, duke përfshirë edhe rikthimin e ankuesve, siç urdhërohet edhe nga gjykatat vendase në lidhje me ankimet nr. 45718/12, 9403/13, 11724/13, 11726/13, 38964/13 dhe



48723/14. Gjykata është e kënaqur që marrëveshjet janë të bazuara mbi respektin për të drejtat e njeriut, siç përcaktohet në Konventë dhe në Protokollet e saj, dhe nuk gjen asnjë arsye të justifikojë shqyrtimin e mëtejshëm të ankesave. Për sa më sipër, vendimi për t'i hequr çështjet nga lista është i duhuri.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht:

Vendos t'i bashkojë ankimet.

Vendos t'i përjashtojë ankimet nga lista e saj e çështjeve, në zbatim të nenit 39 të Konventës.

E hartuar në anglisht dhe e përcjellë me shkrim më 16 prill 2015.

Paul Mahoney
President

Fatoş Arac
Zëvendës Sekretar

SHTOJCË

Nr.	Ankesa nr.	Paraqitur më	Datëlindja dhe Vendbanimi i Ankuesit	Përfaqësuar nga
1.	45718/12	27/06/2012	Ervin LAKO 30/06/1967 Tiranë	
2.	9403/13	09/01/2013	Valbona PALUKA 23/06/1964 Tirana	
3.	11724/13	31/01/2013	Spiro TABA 02/07/1955 Korçë	
4.	11726/13	01/02/2013	Andrea KARANXHA 05/05/1956 Korçë	
5.	38964/13	25/05/2013	Raimonda TRUPJA 05/02/1968 Durrës	
6.	6037/14	11/01/2014	Indrid OSMANI 30/05/1983 Tiranë	
7.	17174/14	19/02/2014	Thanas VERDHI 19/11/1946 Tiranë	
8.	48723/14	23/06/2014	Nazmi LUKU 05/11/1952 Tirana	Erind MËRKURI

VENDIM

Nr. 20, datë 3.6.2015

PËR MOSHQYRTIM TË PROPOZIMEVE PËR NDRYSHIM TARIFE

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar dhe neneve 12, 13 dhe 15 të metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim propozimin për ndryshim tarife për vitin 2015 për shoqërinë “Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë”, sh.a.

2. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Tekniko-Ekonomike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Gjergj Xhuvli

**VENDIM****Nr. 21, datë 3.6.2015**
**MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM
PUBLIK PËR SHOQËRINË “U KORÇË
FSHAT” SHA**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, si dhe vendimit të KKRR nr. 22, datë 14.11.2014, “Për miratimin e përqindjes së pagës rregullatore për vitin 2015”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë “U Korçë Fshat” sh.a.:

a) Tarifë volumetrike për shërbimin e furnizimit me ujë:

Shërbim i matur

Konsumator familjar 38 lekë/m³

Institucione buxhetore 90 lekë/m³

Ente private 95 lekë/m³

Shërbim i pamatur

Konsumator familjar 400 lekë/muaj/klient

b) Tarifë fikse

Konsumator familjar 50 lekë/muaj/klient

Institucione buxhetore 50 lekë/muaj/klient

Ente private 50 lekë/muaj/klient

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2015:

- uji pa të ardhura (humbjet) 29%
- niveli i matjes 67%
- kohëzgjatja e furnizimi 13 orë/ditë
- efica e energjisë 1.2 kwh/m³
- efikasiteti i stafit 7.8 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë 66%
- norma e arkëtimit 94%
- cilësia e ujit (klor+koliform) sipas standardeve.

3. Pagesa rregullatore vjetore për fshat “Sha U Korçë Fshat” do të jetë 0.6% e të ardhurave të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.7.2015 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

ZËVENDËSKRYETARI
Gjergj Xhuveli

VENDIM**Nr. 22, datë 3.6.2015**
**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 6, DATË 26.3.2012 “LICENCIM PËR
HERË TË PARË UJËSJELLËS HIMARË
SHA”**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Në vendimin nr. 6, datë 26.3.2012 “Licencim për herë të parë Ujësjele Himaresha sh.a.” bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhet ndryshimi si më poshtë:
“Drejtues ligjor: Andrea Goro.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Gjergj Xhuveli

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 56 lekë